



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E GJAKOVËS  
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Nr. 01-112/01-13853

Datë 30.08.2024

Kryetari i Komunës së Gjakovës, duke u bazuar në nenin 13 dhe nenin 58 pika b të Ligjit numër 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, nenin 35 të Ligjit numër 08/L-197 për Zyrtarët Publik, nenin 18 të Rregullores (QRK) numër 19/2024 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendësdrejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesional, Asistentëve, Instruktorëve dhe Sekretarëve në Institucionet Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese (IEAA) të Arsimit Parauniversitar, sipas propozimit numër 01-112/01-13782 të datës 30.08.2024 nga Drejtoria për Arsim, me datë 30.08.2024 merr këtë:

V E N D I M

1. Nëpunësja **Gjyle Musa** caktohet ushtrues detyre i Drejtorit të SHFMU "Ahmet Rrustemi" nga data **02.09.2024** deri në përfundimin e procedurave të rekrutimit për zgjedhjen e drejtorit të ri.
2. Caktimi i kryesit të detyrës së drejtorit është i përkohshëm ngase procedura e pranimit/rekrutimit do të zhvillohet sipas rregullave ligjore përkatëse.
3. Zyrtari publik nuk mund të caktohet si ushtrues detyre më gjatë se gjashtë (6) muaj. Kur pozita nuk mund të plotësohet brenda afatit gjashtë (6) mujor, ky afat mund të zgjas më së shumti edhe për gjashtë (6) muaj të tjerë. Pozita e lirë nuk mund të zëvendësohet me ushtrues detyre për më gjatë se afati i përcaktuar. Çdo vendim i marrë nga ushtruesi i detyrës pas kalimit të afatit të përcaktuar është i paligjshëm.
4. Kompensimi duhet të bëhet **sipas koeficientit 6.2** (klasa E14 sipas Ligjit numër 08/L-196 për Pagat në Sektorin Publik).
5. Vendimi hynë në fuqi menjëherë pas nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

**KËSHILLA JURIDIKE:** Pala e pakënaqur me këtë vendim ka të drejtën e ankesës në afatin prej 30 ditësh prej ditës së pranimit të të njëjtit. Ankesa i adresohet Komisionit të Ankesave në kuadër të Komunës së Gjakovës.

**Vendimi iu dorëzohet:**

- Nëpunëses Gjyle Musa
- Drejtorisë për Arsim
- Njësisë për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore
- Arkivit

Ardian Gjini

Kryetar i Komunës së Gjakovës